



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



NIART
Naim Gashi
Kryshhec
Pejë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2022/178 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
Niart (Palë përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 4 nëntor 2020 ka miratuar Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, qëllimi i së cilës është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM ka iniciuar ex officio monitorim në terren të Palës përgjegjëse për të verifikuar pajtueshmërinë lidhur me Rregulloren KPM-2020/01 pas licencimit.
3. KPM me datën 7 shtator 2022 i ka dërguar shkresë Palës përgjegjëse, me anë të së cilës ka kërkuar që në afat brenda pesë (5) ditësh të ofrojë marrëveshje për të drejtat e ritransmetimit të kanaleve: VISION PLUS, KLAN PLUS, KLAN TV, TRING SHQIP, RTK3, TRING JOLLY, TRING 3 PLUS, FIRST CHANNEL, TËVË1, ATV, TRINGTRING, SOFIA, BABY TV, BOOMERANG, DUCK TV, 21 JUNIOR, SKY MOVIE HD, TRING LIFE, SKY MAX, SKY AKSION, SKY DRAMA, SKY KOMEDI, TRING ACTION, TRING COMEDI, TRING SUPER, TRING FANTASY, GEO, SKY HISTORY, TRING WORLD, NATIONAL GEOGRAPHIC, NATIONAL GEOGRAPHIC, TRING PLANET, TRING HISTORY, FOX, FOX LIFE, FOX CRIME, FOX MOVIE, DOCU BOX, DISCOVERY CHANNEL, 24 KITCHEN, FOX NEWS, TV DUKAGJINI, RTK 4, ORA NEWS, ARTA NEWS, LIVING, RTSH, ON TV, 21 PLUS, 21 POPULLORE, ZICO TV, BBF, A-MOL, DASMA TV, RTV FONTANA, FIGHT BOX, EURO SPORT, EUROSPORT2, FASTBOX&FUN, GAME TOON, FASHION TV, 360 TUNEBOX, BESA TV, SYRI VISION, TV MITROVICA, TV TEMA, TV OPINION, TV ERA, KIKA, PRO SIBEN, PRO SIBEN MAX, SAT.1, SAT.1 GOLD, KABEL EINS, KABEL EINS DOKU, ZDF, ZDF INFO, ZDF NEO, RTL, RTL PLUS, RTL 2, N-TV, DMAX, VOX, TELE 5, NITRO, FRANCE 24, TRT WORLD HD, CGTN, CGTN DOCUMENTAR, AL JAZERA BALLKAN, PEACE TV, BBC WORLD, CNN INT, EURO NEWS, RAI1, RAI2, RAI3, FILM BOX PREMIUM, FILM BOX EXTRA, SKY NOVELA, FILM BOX ART HOUSE, TV PLUS, RTV 21 MACEDONIA, SYRI TV, RTV FESTINA, TV

PRIZRENI, TV DIELLI, SHENJA TV, TV OPOJA, SMILE, TV LLAPI, CHKICK CHANNEL, ZERI TV, TV VALI, TURBO CHANNEL, TV LIRIA, MTV KOSOVA, MTV, MTV HITS, MTV ROCKS, VHI, VHI CLASSIC, STAR TV, NUMBER ONE TV, KRAL TV, SHOW TURK, ATV, TEK RUMELI, KANAL D, HAYAT, TRT TURK dhe HRT.

4. KPM me datën 7 shtator 2022 ka pranuar përgjigje nga ana e Palës përgjegjëse në të cilën e ka konfirmuar pranimin e shkresës dhe ka pohuar se marrëveshjet do t'i deponojë gjatë javës në vijim për kanalet të cilat janë në ritransmetim.
5. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit të datës 15 shtator 2022, ka gjetur se Pala përgjegjëse edhe përkundër kërkesës së KPM-së për sjelljen e marrëveshjeve është duke ritransmetuar kanalet e lartpërmendura pa marrëveshje valide.
6. Pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 28 shtator 2022 KPM i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka udhëzuar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2020/01, duke i larguar nga ritransmetimi kanalet e lartpërmendura të cilat i ritransmeton pa marrëveshje, menjëherë pas pranimit të njoftimit, në të kundërtën Zyra Ekzekutive e KPM-së do t'i rekomandojë Komisionit të ndërmarrë masa ligjore në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
7. KPM me datën 28 shtator 2022 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse në të cilën theksohet se: *“Ne e kemi të finalizuar marrëveshjen me Kompaninë Telkos por për arsye teknike nga ana e tyre nuk kemi mundur ta sjellim marrëveshjen. Të hënën do ta sjellim dokumentin e kërkuar”*, mirëpo edhe pas kësaj Pala përgjegjëse nuk ka sjellë marrëveshje për kanalet e lartpërmendura, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2020/01.
8. KPM pas Njoftimit për shkelje ka bërë sërish monitorimin e Palës përgjegjëse nëse ka ardhur në pajtueshmëri duke i larguar nga ritransmetimi kanalet e lartpërmendura të cilat i ritransmeton pa marrëveshje. Bazuar në Raportin e monitorimit të datës 5 nëntor 2022 KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse nuk ka dorëzuar ndonjë marrëveshje brenda afatit të dhënë, duke vepruar kështu në shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01.

Analiza ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura, ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2020/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale bazuar vetëm në marrëveshjet valide për shpërndarjen e tyre.”


10. KPM, bazuar në Raportet e monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01, duke transmetuar pa marrëveshje valide kanalet e lartpërmendura.
11. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01.

Vendim

12. Pala përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej dy mijë (2.000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, pika 1.3, të Ligjit të KPM-së për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Jeton Mehmeti
Kryetar



24.11.2023
Datë